

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 15 dhe neni 96 paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/2, 154/23 dhe 55/24), neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 15 të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr.01-3732/1 të datës 29.07.2019, dhe në lidhje me nenin 76-v paragrafi (1), neni 75, neni 75-gj paragrafi (1), neni 76, neni 76-a paragrafët (2) dhe (8) dhe neni 76-b të Kodit Zgjedhor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.40/06, 136/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24 dhe 76/24) dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.02-2043/2 datë 25.04.2024, u përgatit tekst i pastruar i Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024.

Teksti i pastruar i Udhëzimit për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024 përfshin: Udhëzim për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, ark.nr.01-1550/1 datë 29.03.2024, Udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, ark.nr.01-1911/1 datë 15.04.2024 dhe Udhëzim për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare 2024, ark.nr.01-1911/2 datë 26.04.2024.

**UDHËZIM PËR TRANSMETUESIT PËR
ZGJEDHJET PRESIDENCIALE DHE PARLAMENTARE 2024
(TEKST I PASTRUAR)**

1. Ky udhëzim sqaron mënyrën e zbatimit të rregullave të Kodit Zgjedhor për limitet e reklamimit të paguar politik (RPP), shënimin e porositësit të reklamës, ndarjen e kohës në lajme të Shërbimit Publik Radiodifuziv (SHPR), përfaqësimin politik pa pagesë në kanalën e Kuvendit, ofrim të qasjes së përmbajtjeve të procesit zgjedhor për personat me aftësi të kufizuara, si dhe rregullat e raportimit në ditët e heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, veçanërisht për periudhën që përputhen të dy proceset zgjedhore.

Reklamim i paguar politik

2. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, në rrethin e parë të votimit, radiodifuzerët mund të transmetojnë gjithsej nëntë minuta dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) kohë shtesë për reklamim në orë reale program të transmetuar, ekskluzivisht destinuar për reklamim të paguar politik.

3. Në pajtim me ndarjen e kohës për reklamim të paguar politik përcaktuar në nenin 75-gj paragrafi (1) të Kodit Zgjedhor, gjithsej nëntë minutat dhe tridhjetë sekonda (00:09:30) në orë reale program të transmetuar, parashtruesit e listave do t'i shfrytëzojnë sipas mënyrës në vijim:
 - Në maksimum 4 minutat destinuar për dy partitë më të mëdha politike nga pozita, të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më së shumti vota, do të transmetohet reklamim i paguar politik i parashtruesve të listave/kandidatëve për kryetar - Stevo Pendarovski, mbështetur nga partia politike LSDM; dhe Bujar Osmani, mbështetur nga partia politike BDI.
 - Në maksimum 4 minuta destinuar për dy partitë më të mëdha politike në opozitë, të cilët në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më së shumti vota, do të transmetohet reklamim i paguar politik i parashtruesve të listave/kandidatëve për kryetar - Gordana Siljanovska-Davkova, mbështetur nga partia politike VMRO-DPMNE; dhe Arben Taravari, mbështetur nga partitë politike Alternativa dhe Lëvizja BESA.
 - Në maksimum 1 (një) minutë destinuar për partitë politike në Kuvend, që në zgjedhjet e fundit për deputet nuk fituan deputetë mjaftueshëm për të formuar grup parlamentar do të transmetohet reklamim i paguar politik për parashtruesit e listave/kandidatëve për kryetar - Biljana Vankovska Cvetkovska, mbështetur nga partia politike e Majtë; dhe Stevço Jakimovski, mbështetur nga partia politike GROM.
 - Në 30 sekondat e mbetura destinuar për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend apo kandidatë, do të transmetohet reklamim i paguar politik për parashtruesin e listës/kandidatit për kryetar - Maksim Dimitrievski, mbështetur nga partia politike ZNAM.

4. Koha e lejuar për reklama ndërmjet parashtruesve të listave do të ndahet në bazë të marrëveshjes paraprake me shkrim ndërmjet tyre. Në të njëjtën kohë, çdo parashtrues i listës/kandidat për president mund të marrë me qira kohën totale të lejuar për RPP të kategorisë së tyre (4 minuta/4 minuta/1 minutë/30 sekonda), nëse nuk ka interes nga parashtruesi/kandidati tjetër i listës për kryetar dhe nëse është në pajtim me marrëveshjen e arritur.

5. Gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, në rrethin e dytë të votimit, radiodifuzerët mund të transmetojnë gjithsej tetë minuta (00:08:00) kohë shtesë reklamim në

orë reale transmetim programi, ekskluzivisht destinuar për reklamim të paguar politik, nga të cilat maksimumi katër minuta (00:04:00) për parashtruesin e listës/kandidatin për kryetar – Stevo Pendarovski, mbështetur nga partia politike LSDM, dhe maksimumi katër minuta (00:04:00) për parashtruesen e listës/kandidates për kryetare – Gordana Siljanovska-Davkova, mbështetur nga partia politike VMRO-DPMNE.

6. Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare, radiodifuzerët kanë të drejtë në gjithsej nëntë minuta e tridhjetë sekonda shtesë (00:09:30) për reklama në orë reale transmetim programi ekskluzivisht destinuar për reklamim të paguar politik (RPP).

7. Në total, nëntë minuta e tridhjetë sekonda (00:09:30) në orë reale të transmetimit të programit për reklamim të paguar politik për Zgjedhjet parlamentare, parashtruesit e listave do t'i shfrytëzojnë në pajtim me ndarjen e kohës së përcaktuar në nenin 75gj paragrafi (1) të. Kodit Zgjedhor dhe atë:

- Në maksimum 4 minuta destinuar për dy partitë më të mëdha politike nga pozita, që në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më së shumti vota, do të transmetohet reklamim i paguar politik i parashtruesve të listave - KOALICIONI PËR ARDHMËRINË EVROPIANE dhe KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN.

- Në maksimum 4 minuta destinuar për dy partitë më të mëdha politike në opozitë, që në zgjedhjet e fundit parlamentare fituan më së shumti vota, do të transmetohet reklamim i paguar politik i parashtruesve të listave- KOALICIONI "MAQEDONIA JUAJ" VMRO-DPMNE dhe KOALICIONI VLEN.

- Në maksimum 1 minutë destinuar për partitë politike në Kuvend, që në zgjedhjet e fundit për deputet nuk fituan numër të mjaftueshëm deputetësh për formimin e grupit parlamentar, do të transmetohet reklamim i paguar politik për parashtruesit e listave- PARTIA E MAJTË dhe KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.

- Në 30 sekondat e mbetura destinuar për partitë politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend apo kandidatët, do të transmetohet reklamim i paguar politik për parashtruesit e listave:

- ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
- ✓ Partia Politike AVAJA;
- ✓ PARTIA LËVIZJE CIVILE EVROPIANE;
- ✓ MAQEDONI E VETME;
- ✓ EPARTIA MAQEDONASE ERA E TRETË/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
- ✓ PARTIA DEMOKRATËT;
- ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;

- ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
- ✓ PARTIA RODINA MAQEDONI; ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
- ✓ PARTI JUAJ.

8. Kështu, koha totale për reklamim të paguar politik në orë reale për program të transmetimit për radiodifuzerët do të jetë:

- nëntë minuta e tridhjetë sekonda (00:09:30) në periudhën nga data 4 deri më 17 prill 2024;
- nëntëmbëdhjetë minuta (00:19:00) në periudhën nga data 18 deri më 22 prill 2024;
- nëntë minuta e tridhjetë sekonda (00:09:30) më datë 23 dhe 24 prill 2024; dhe
- në periudhën nga data 25 prilli deri më 6 maj 2024, nëntë minuta e tridhjetë sekonda (00:09:30) për Zgjedhjet parlamentare dhe tetë minuta (00:08:00) për rrethin e dytë të Zgjedhjeve presidenciale.

9. Gjatë lidhjes së kontratave për reklamim të paguar politik dhe transmetimin e tij, radiodifuzerët duhet të kujdesen për respektimin e kufirit total të lejuar për orë reale për secilën nga kategoritë e parashtruesve të listave dhe për respektimin e kohës totale të lejuar për RPP për orë reale transmetim programi.

10. Në pajtim me nenin 76 paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor, në të gjitha format e reklamimit të paguar politik, porositi i reklamës duhet të identifikohet qartë.

11. Si porositi të reklamimit për Zgjedhjet presidenciale duhet të paraqiten emrat e kandidatëve për kryetar - Stevo Pendarovski, Bujar Osmani, Gordana Siljanovska-Davkova, Arben Taravari, Biljana Vankovska-Cvetkovska, Stevço Jakimovski dhe Maksim Dimitrievski.

12. Si porositi të reklamimit për Zgjedhjet parlamentare duhet të paraqiten emrat e parashtruesve të listave të verifikuara të kandidatëve për deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht listat e verifikuara në vijim:

- ✓ KOALICION PËR ARDHMËRINË EVROPIANE;
- ✓ KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN;
- ✓ KOALICIONI “MAQEDONIA JUAJ” VMRO-DPMNE;
- ✓ KOALICIONI VLEN;

- ✓ PARTIA E MAJTË;
- ✓ KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË; ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
- ✓ Partia Politike AVAJA;
- ✓ PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE;
- ✓ MAQEDONI E VETME;
- ✓ PARTIA MAQEDONASE ERA E TRETË/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
- ✓ PARTIA DEMOKRATËT;
- ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;
- ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
- ✓ PARTI RODINA MAQEDONI; ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
- ✓ PARTIA JUAJ.

Ndarja e kohës në lajmet e SHPR

- 13.** Në pajtim me nenin 76-a paragrafi (2) të Kodit Zgjedhor, gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, në rrethin e parë të votimit, Shërbimi publik radiodifuziv për parashtuesit e listave/kandidatëve për kryetar në lajme informon si më poshtë:
- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar - Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani;
 - në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar - Gordana Siljanovska-Davkova, Arben Taravari, Biljana Vankovska-Cvetkovska dhe Stevço Jakimovski;
 - në 10% të kohës për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për kandidatët e pavarur, informon për fushatën zgjedhore të kandidatit për kryetar - Maksim Dimitrievski.
- 14.** Nga data 18 prill 2024, me fillimin e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare që përfundon më datë 22 prill 2024, Shërbimi publik radiodifuziv në të njëjtat tri njësi (30%+30%+10%) të lajmeve informon edhe për parashtuesit e listave për këtë proces zgjedhor, pra:

- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar - Stevo Pendarovski dhe Bujar Osmani, dhe për parashtruesit e listave për deputetë - KOALICIONI PËR ARDHMËRINË EVROPIANE dhe KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN.
- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë, informon për fushatën zgjedhore të kandidatëve për kryetar - Gordana Siljanovska-Davkova, Arben Taravari, Biljana Vankovska-Cvetkovska dhe Stevço Jakimovski, si dhe për parashtruesit e listave për deputetë - KOALICIONI "MAQEDONIA JUAJ" VMRO-DPMNE; KOALICIONI VLEN; PARTIA E MAJTË; dhe KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.
- në 10% të kohës për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për kandidatët e pavarur, informon për fushatën zgjedhore të kandidatit për kryetar - Maksim Dimitrievski dhe për parashtruesit e listave për deputetë - LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË; Partia Politike AVAJA; PARTIA LËVIZJA CIVILE EVROPIANE; MAQEDONI E VETME; PARTIA MAQEDONASE ERA E TRETË/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT; PARTI DEMOKRATËT; PARTIA POLITIKE E DJATHTË; PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP; PARTIA RODINA MAQEDONI; PARTIA E PUNËTORËVE; dhe PARTIA JUAJ.

14-a. Nga data 25 prill 2024, me fillimin e rrethit të dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, shërbimi publik radiodifuziv në të tri njësitë (30%+30%+10%) të lajmeve informon edhe për kandidatët për president dhe për parashtruesit e listave të deputetëve, d.m.th.

- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në pushtet, informon për fushatën zgjedhore të kandidatit për kryetar - Stevo Pendarovski dhe parashtruesve të listave për deputetë - KOALICIONI PËR ARDHMËRINË EVROPIANE dhe KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN.
- në 30% të kohës për aktivitetet e partive politike në opozitë, informon për fushatën zgjedhore të kandidatës për kryetare - Gordana Siljanovska-Davkova dhe parashtruesve të listave për deputetë - KOALICIONI "MAQEDONIA JUAJ" VMRO-DPMNE; KOALICIONI VLEN; PARTIA E MAJTË; dhe KOALICIONI TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.
- në 10% të kohës për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për kandidatët e pavarur, informon për fushatën zgjedhore të parashtruesve të listave për deputetë - LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË; Partia Politike AVAJA; PARTI LËVIZJE CIVILE EVROPIANE; MAQEDONI E VETME; PARTIA MAQEDONASE ERA E TRETË/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT; PARTIA DEMOKRATËT; PARTIA POLITIKE E

DJATHTË; PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP; PARTI RODINA MAQEDONI; PARTIA E PUNËTORËVE; dhe PARTIA JUAJ.

Përfaqësimi politik pa pagesë në kanalën e Kuvendit

- 15.** Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, në rrethin e parë të votimit, Shërbimi programor destinuar për transmetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ofron (sigurojë) tre orë përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të secilit prej parashtruesve të listave/kandidatëve për kryetar të mbështetur nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe gjithsej një orë për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- 16.** Nga tri (3) orë përfaqësim politik pa pagesë gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, do të marrë secili prej parashtruesve të listave/kandidatëve në fjalë për kryetar: Stevo Pendarovski, Bujar Osmani, Gordana Siljanovska-Davkova, Arben Taravari, Biljana Vankovska- Cvetkovska dhe Stevço Jakimovski.
- 17.** Gjithsej një (1) orë përfaqësim politik pa pagesë gjatë kohës së rrethit të parë të fushatës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale do t'i jipet kandidatit për kryetar Maksim Dimitrievski.
- 18.** Në rrethin e dytë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, shërbimi programor i dedikuar për transmetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ndajë kohë të barabartë, nga tre (3) orë, për përfaqësim politik pa pagesë për secilin prej dy kandidatëve për kryetar - Gordana Siljanovska-Davkova dhe Stevo Pendarovski.
- 19.** Gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare, Shërbimi programor i destinuar për transmetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të ofrojë gjithsej tre orë në ditë për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe gjithsej një orë në ditë për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave për parashtruesit e listave të cilët nuk janë të përfaqësuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- 19-a.** Kohën prej gjithsej tre (3) orësh, çdo ditë, për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave për deputetë do ta shfrytëzojnë:

- ✓ KOALICION PËR ARDHMËRINË EVROPIANE;
- ✓ KOALICIONI PËR FRONTIN EVROPIAN;
- ✓ KOALICIONI “MAQEDONIA JUAJ” VMRO-DPMNE;
- ✓ KOALICIONI VLEN;
- ✓ PARTI E MAJTË; dhe
- ✓ KOALICION TRIMËRISHT PËR MAQEDONINË.

19-b. Kohën prej gjithsej një (1) ore, çdo ditë, për përfaqësim politik pa pagesë të fushatave të parashtruesve të listave për deputetë do ta shfrytëzojnë:

- ✓ LËVIZJA E DI - PËR MAQEDONINË TONË;
- ✓ Partia Politike AVAJA;
- ✓ PARTIA LËVIZJE CIVILE EVROPIANE;
- ✓ MAQEDONIA E VETME;
- ✓ PARTIA MAQEDONASE ERA E TRETË/LISTAT E PAVARUR TË MAQEDONISË – SOVRANISTËT;
- ✓ PARTI DEMOKRATËT;
- ✓ PARTIA POLITIKE E DJATHTË;
- ✓ PARTIA POLITIKE ALTERNATIVA E RE SHKUP;
- ✓ PARTIA RODINA MAQEDONI; ✓ PARTIA E PUNËTORËVE; dhe
- ✓ PARTI JUAJ.

20. Për mënyrën e shfrytëzimit të kohës për përfaqësim politik pa pagesë do të vendosë shërbimi programor i destinuar për transmetimin e aktiviteteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me politikën e tij redaktuese, për të cilën me kohë do t'i njoftojë parashtruesit e listave.

Qasja në përmbajtjet për procesin zgjedhor

21. Shërbimi pulik radiodifuziv në nivel shtetëror që do të publikojnë reklamim të paguar politik, në pajtim me detyrimet e nenit 75 paragrafët (1), (4) dhe (5) të Kodit Zgjedhor, përmbajtjet lidhur me procesin zgjedhor duhet t'i transmetojnë në format të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara.

22. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet në nivel shtetëror do të ofrojnë qasje në:

- të paktën një edicion lajmesh, në periudhën nga ora 16:00 deri në ora 24:00, çdo ditë; dhe
- të paktën një emision tjetër lidhur me procesin zgjedhor, në periudhën nga ora 16:00 deri në ora 24:00, një herë në javë.

23. Shërbimi publik radiodifuziv dhe televizionet në nivel shtetëror që do të publikojnë reklamim të paguar politik, të dhënat për përmbajtjet e ofruara lidhur me fushatën zgjedhore, duhet t'i dorëzojnë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, më së voni deri më datë 1 prill 2024.

Heshtje zgjedhore

24. Gjatë kohës së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, më datë 23 dhe 24 prill (deri në orën 19:00) 2024, vazhdon fushata zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare, por ndalon mbulimi mediatik në lajmet dhe emisionet speciale-informative të pjesëmarrësve në fushatat zgjedhore për të dy proceset zgjedhore.

25. Për aktivitetet e fushatës zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare që do të ndodhin më datë 23 dhe 24 prill 2024, radiodifuzerët në pajtim me politikën e tyre redaktuese, mund të informojnë më datë 24 prill pas orës 19:00, pra pas mbylljes së qendrave të votimit.

26. Gjatë kohës së heshtjes zgjedhore për Zgjedhjet presidenciale, vazhdon transmetimi i formave të “qasjes së drejtpërdrejtë te votuesit” (përfaqësim politik pa pagesë dhe reklamim të paguar politik) të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet parlamentare.

Dispozitat përfundimtare

(pika 27 e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, ark.nr.01-1550/1 datë 29.03.2024)

27. Duke pasur parasysh se gjatë periudhës së miratimit të këtij Udhëzimi nuk dihen të gjitha të dhënat për parashtruesit e listave për proceset zgjedhore, veçanërisht në lidhje me pikat 5, 7, 8, 12, 14 dhe 19, në periudhën në vijim, nëse është e nevojshme, Udhëzimi do të plotësohet në përputhje me rrethanat.

(pika 28 e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, ark.nr.01-1550/1, datë 29.03.2024)

28. Ndryshimet dhe plotësimet në këtë Udhëzim bëhen me shkrim.

(pika 29 e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, Ark.nr.01-1550 datë 29.03.2024)

29. Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

(pika 5 e Udhëzimit për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet presidenciale dhe Parlamentare 2024, ark.nr.01-1911/1 datë 15.04.2024)

30. Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

(pika 6 e Udhëzimit për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për transmetuesit për Zgjedhjet Presidenciale dhe Parlamentare 2024, ark.nr.01-1911/2, datë 26.04.2024)

31. Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

**Nr.01-2071/1
26.04.2024
Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**